

VENDIM
Nr. 1045, datë 23.12.2015

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË DISA PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE NË GODINËN NR. 57, NË BULEVARDIN “ZOGU I
PARË”, TIRANË, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 450, DATË 16.6.2005,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI DREJTORISË
SË SHËRBIMIT
TË TRUPIT DIPLOMATIK”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 901 e vijues të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare te Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, të pronës së paluajtshme shtetërore, apartamentet nr. 15, nr. 16, nr. 17 dhe nr. 18, në godinën nr. 57, në bulevardin “Zogu i Parë”, Tiranë, sipas planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi, të cilat me vendimin nr. 957, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, u janë dhënë në përdorim, pa shpërblim, si mjedise pune, ish-presidentëve të Republikës së Shqipërisë.
2. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 450, datë 16.6.2005, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.
3. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik te Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, të pronës së paluajtshme shtetërore, apartamentet nr. 6 dhe nr. 2, në godinën nr. 57, në bulevardin “Zogu i Parë”, Tiranë, sipas planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi, për t’ua dhënë në përdorim pa shpërblim, si mjedise pune ish-presidentëve të Republikës së Shqipërisë.
4. Prona e përcaktuar në pikën 3, të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 450, datë 16.6.2005, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.
5. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.
6. Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim apo ta tjetërsojë atë.
7. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Punëve të Jashtme, Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama





